

VENDIM
Nr. 158, datë 30.12.2020

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME BELSH SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 30.12.2020 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projekt vendimit “Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Belsh sh.a.”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Belsh (UK Belsh) me shkresën nr. 112/1 prot., datë 3.12.2020, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Belsh në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezultoi:

a) Shoqëria UK Belsh ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 32 630 banorë të Bashkisë Belsh;

b) Drejtues teknik i shoqërisë z. Ndrizim Sinani është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, dega “Hidroteknikë”, në vitin 1995, plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Belsh, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjiellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Belsh është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore, të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Belsh sh.a., me (NUIS L63215202R), në kategoritë:

a) kategoria A – për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) kategoria C – për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Belsh sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara, me:
- a) drejtues ligjor: Endri Pepa;
 - b) drejtues teknik: Ndriçim Sinani.
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Belsh sh.a. është Bashkia Belsh.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Belsh sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Belsh sh.a. për marrjen e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani